

UDHËZIM
Nr. 3799, datë 8.7.2014

**PËR NGRITJEN E AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR IDENTIFIKIMIN, REFERIMIN, MBROJTJEN
DHE RIINTEGRIMIN E VIKTIMAVE/VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 582, datë 27.7.2011, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave / viktimave të mundshme të trafikimit”.

UDHËZOJME:

1. Ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave / viktimave të mundshme të trafikimit, këtej e tutje referuar si autoriteti përgjegjës.

2. Autoriteti përgjegjës të ketë këtë përbërje:

a) Drejtori i Njësisë Antitrafik – kryetar

b) 1 përfaqësues nga Sektori kundër Trafikeve të Paligjshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit – anëtar

c) 1 përfaqësues nga Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit – anëtar

d) 1 përfaqësues nga Sektori i Dhunës në Familje dhe Mbrojtjes së të miturve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit - anëtar

e) 1 përfaqësues nga Shërbimi Social Shtetëror - anëtar

f) 1 përfaqësues nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë - anëtar

g) 1 përfaqësues nga Drejtoria Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme – anëtar

h) 1 përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë – anëtar

i) 1 përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit - anëtar

j) Kryetari i KKSAT- anëtar

3. Autoriteti përgjegjës të udhëheqë zbatimin e Mekanizimit Kombëtar të Referimit lidhur me të gjitha rastet e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar dhe referuar në bazë të këtij mekanizmi në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit.

4. Autoriteti përgjegjës hedh të dhënat në Sistemin e Informacionit për Viktimat e Trafikimit (SIVET) sipas rubrikave përkatëse mbi çdo rast të identifikuar dhe referuar.

5. Autoriteti përgjegjës të mblidhet në mënyrë periodike një herë në muaj, në varësi të rasteve të referuara.

6. Autoriteti përgjegjës t'i raportojë zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, njëkohësisht Koordinator Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në mënyrë periodike një herë në muaj, sipas nevojës për gjithë veprimtarinë e tij.

7. Të merren të gjitha masat për krijimin, plotësimin e infrastrukturës, logjistikës dhe financimit të nevojshëm, në drejtoritë përkatëse të këtyre institucioneve, për të trajtuar referimet e të gjitha viktimave të trafikimit, si dhe për të kryer të gjitha funksionet e tjera të bashkërendimit dhe raportimit, të cilat iu kërkojnë sipas këtij udhëzimi.

8. Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik, përveç sa parashikohet në këtë udhëzim, mund të trajtojnë në mënyrë më të detajuar çështje të interesit të përbashkët nëpërmjet marrëveshjeve të përbashkëta, që mund të lidhin për këtë qëllim.

9. Ngarkohet autoriteti përgjegjës të hartojë rregulloren e veprimit dhe të funksionimit të tij brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

10. Urdhri i përbashkët i ministrit të Brendshëm nr. 3394/4, datë 17.5.2006, i ministrit të Punëve të Jashtme nr. 7590, datë 24.5.2006 dhe i ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 1152, datë 19.5.2006, “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave të trafikimit dhe përcaktimin e detyrave të institucioneve të përfshira në këtë proces”, shfuqizohet.

11. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe autoriteti përgjegjës, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDASHME
Saimir Tahiri

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Ditmir Bushati

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Ilir Beqaj

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Erion Veliaj